



11 shkurt 2015

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

“Ndërmarrja e re “Hotel Grand”sh.p.k.

Prishtinë - Bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 26 - 31 gusht 2014 ka vendosur që të iniciohet procesi i likuidimit edhe për Ndërmarrja e Re Hoteli Grand sh.p.k.

Sipas këtij vendimi procesi i likuidimit për Ndërmarrja e Re Hoteli Grand sh.p.k. ka filluar me datë 2 shkurt 2015. Agjencia edhe për këtë ndërmarrje ka ndërmarrë të gjitha veprimet të cilat parashihen me ligj. Deri me datë 3 shkurt 2015 të gjithë ish të punësuarit në këtë ndërmarrje i kanë nënshkruar njoftimet mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Neni 8 i shtojcës së ligjit të Agjencisë nr.04/L-034 thotë: “Në mesnatën e datës së Vendimit për Likuidim prishen të gjitha kontratat e punës që kanë qenë në fuqi deri atëherë ndërmjet ndërmarrjes dhe punonjësve të saj, nëse tilla ekzistojnë”.

Të gjitha palët duke përfshirë edhe ish punëtorët e “Ndërmarrja e Re Hoteli Grand” sh.p.k. kërkesat/pretendimet e tyre mund të i dorëzojnë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit duke filluar nga data 9 shkurt 2015 sipas shpjegimeve të dhëna në njoftimin e publikuar për fillimin e likuidimit.

Agjencia është në fazën e shqyrtimit të pasqyrave financiare të ndërmarrjes dhe në bazë të saj do të përgatitë planin e angazhimit të numrit të nevojshëm të Ofruesve të Shërbimeve lidhur me mbarëvajtjen e aktiviteteve të nevojshme në Ndërmarrja e Re Hoteli Grand sh.p.k. në likuidim deri në momentin e privatizimit.

Agjencia po ashtu do të përkujdeset që mos të lejoj që “Ndërmarrja e Re Hoteli Grand” sh.p.k. në likuidim të operoj me humbje deri në shitjen e këtyre aseteve përndryshe operimi me humbje do të shkaktonte humbje indirekte për buxhetin Kosovës.

FUND